




Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
**Swiss Cooperation for Development
and Cooperation SDC**



United Nations
ALBANIA



TË RINJTË BASHKIA E FIERIT



Qershor 2018



**Leave
No One
Behind**



Autor:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky Publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Rr. "Blv. Bajram Curri" Nd. 136, H. 14, Ap. 1

Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00355 42 258 987

Email: info@observator.org.al

Webmail: www.observator.org.al

Ky Publikim është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos Mbetet Pas"), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t'i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

Përmbajtja e këtij Publikimi është përgjegjësi e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në emër të rrjetit të organizatave "Zëri i të rinjve". Opinione të shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së, UN Albania apo SDC.

Në periudhën Prill - Maj 2018 janë anketuar 100 të rinj nga Bashkia e Fierit me qëllim matjen e njohurive të tyre mbi:

- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs)
- Shëndetin Seksual dhe Riprodhues
- Programet dhe shërbimet e Bashkisë për të rinjtë

PROFILI I TË RINJVE TË ANKETUAR:

• **Grupmosha:** 14 - 29 vjeç

• **Vendndodhja:**

75% nga zonat urbane

- Shkolla e mesme artistike

“Jakov Xoxa”

- Shkolla 9 vjeçare “Pinellopi Pirro”

- Shkolla 9 vjeçare “Janaq Kilica”


- Bashkia Fier

25% nga zonat rurale

- Libofshë

- Qendër

- Mbrostar



62 përqind
e të rinjve të anketuar janë
vajza

FAKTE MBI TË RINJTË E FIERIT

A. NJOHURITË MBI OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË
QËNDRUESHËM (SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS - SDGs)




Afërsisht 1 në 15
të rinj kanë dëgjuar se çfarë janë SDGs

Ndërmjet të rinjve që kanë njohuri mbi SDGs rezulton se:

- a. **Interneti (67% e rasteve) është burimi më i shpeshtë i informacionit** për të rinjtë në zonat urbane për pasurimin e njohurive të tyre mbi këtë çështje.
- b. **Shkolla (67% e rasteve) është burimi më i shpeshtë i informacionit** për të rinjtë në zonat rurale për pasurimin e njohurive të tyre mbi këtë çështje.
- c. **Familja** gjithashtu është burim informacioni për të rinjtë në zonat urbane. Ndërsa në asnjë rast, të rinjtë e anketuar të zonave rurale që kanë njohuri mbi SDGs, nuk janë shprehur se e kanë marrë këtë informacion nga familja.

Institucionet lokale dhe Organizatat e shoqërisë civile nuk janë listuar si burime për marrjen e informacionit mbi SDGs nga të rinjtë e zonave urbane dhe rurale. Interesant është fakti se ndërsa të rinjtë e zonave rurale shprehen se informacionin për SDGs e marrin kryesisht nëpërmjet shkollës, kjo gjë nuk është evidentuar në asnjë rast nga të rinjtë e zonave urbane.




ANGAZHIMI I TË RINJVE NË ARRITJEN E SDGs

Të rinjtë janë pyetur në lidhje me angazhimin personal dhe përfshirjen në aktivitete të ndryshme mbi SDGs.

Shumica e të rinjve të grupmoshave të ndryshme **(84% e rasteve)** nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje.

Vetëm 1% e të rinjve të grupmoshës 14 – 18 vjeç shprehen se janë përfshirë personalisht në arritjen e SDGs, ndërsa 3% e të rinjve shprehen se janë përfshirë pjesërisht për arritjen e SDGs.

1% e të rinjve të grupmoshës 14-18 vjeç shprehen se dëshirojnë të përfshihen, por nuk kanë informacionin e nevojshëm se si mund të ndodh kjo gjë.



Të rinjtë janë pyetur edhe mbi rolin që ata mendojnë se mund të kenë për arritjen e SDGs.



ROLI i të RINJVE në arritjen e SDGs (sipas të rinjve të anketuar)

- Përfshirja aktive e të rinjve në çështje me rëndësi për ta;
- Mundësi më të gjera informimi mbi prioritetet që të rinjtë në këto zona kanë, si edhe krahasimin me bashkëmoshatarët e tyre në zona të tjera;
- Mbajtja në llogaridhënie e zyrtarëve publikë duke i përfshirë nevojat e të rinjve në axhendat e tyre.


FAKTE MBITË RINJTË E FIERIT

B. NJOHURITË MBI SHËNDETIN SEKSUAL DHE RIPODHUES

Të rinjtë janë pyetur edhe mbi njohuritë e tyre në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues.

Pjesa më e madhe e të rinjve të anketuar kanë marrë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues. Anketimi tregoi se **1 në 13** të rinj nuk kanë marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues. Shumica e të rinjve që kanë pohuar se nuk kanë marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues i përkasin zonave urbane. Ndërsa midis të rinjve më të informuar janë vajzat në zonat urbane (46%), edhe të rinjtë me pak të informuar janë meshkujt në zonat rurale (7%).


Përqindja e të rinjve që kanë marrë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues




Ndërmjet të rinjve që kanë njohuri mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, **shkolla dhe interneti janë burimi më i shpeshtë i informacionit të përdorur** për pasurimin e njohurive të të rinjve mbi këtë çështje.

Ndërsa **shkolla, interneti, trajnimet, bashkia dhe fletëpalosjet konsiderohen mjetet ideale për marrjen e informacionit** për shëndetin seksual dhe riprodhues nga ana e të rinjve.

Burimet e informacionit



Përqindja e të rinjve që i'u është folur në shkollë për:




Shumica e të rinjve (49%) shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është pjesërisht i mjaftueshëm.

Interesante është rezultati mbi 27% e të rinjve në zonat urbane që shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është i mjaftueshëm, përkundërt 7% të të rinjve në zonat rurale. Asnjë prej të rinjve të anketuar në zonat rurale nuk është shprehur se informacioni mbi shëndetin seksual dhe riprodhues i marrë në shkollë është i pamjaftueshëm.

Shumica prej të rinjve të zonave rurale janë shprehur se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është pjesërisht i mjaftueshëm.

A është i mjaftueshëm informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues?




Nga anketimi i të rinjve në Fier, rezultoi se shumica e tyre **(48% në zonat rurale dhe 45% në zonat urbane) nuk flasin me prindërit** e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues.

Vetëm **17% e të rinjve të anketuar në zonat urbane dhe 28% e të rinjve në zonat rurale** pohojnë se flasin me prindërit e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues.

Në radhët e të rinjve që flasin mbi këtë tematikë, rezulton se 27% e të rinjve në zonat urbane dhe 28% e të rinjve në zonat rurale komunikojnë vetëm me nënën, ndërsa një pjesë më e vogël preferojnë të komunikojnë vetëm me babain.

Interesante është rezultati i **8% i të rinjve në zonat rurale që shprehen se prindërit nuk i lejojnë** të komunikojnë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues në familjet e tyre. Kjo gjë është komunikuar nga vajza të anketuara në zonat rurale duke evidentuar nevojën dhe rëndësinë e adresimit të kësaj tematike me prindërit.




FAKTE MBITË RINJTË E DURRËSIT

C. NJOHURITË MBI PROGRAMET DHE SHËRBIMET E BASHKISË PËR TË RINJTË

1 në 4 të rinj janë në dijeni të programeve/ prioriteteve të Bashkisë në lidhje me të rinjtë. Ndër të rinjtë që janë shprehur se janë në dijeni të programeve që ofron Bashkia e Fierit për të rinjtë, pjesën më të madhe e zënë vajzat nga zonat urbane me 39%. Ndërsa djemtë nga zonat rurale janë më pak të informuar për programet dhe shërbimet që ofron Bashkia për të rinjtë (në masën 9%).



Shumica e të rinjve (61% në zonat urbane dhe 60% në zonat rurale) shprehen se **nuk kanë marrë ndonjëherë** pjesë në takime që Bashkia ka zhvilluar me të rinjtë për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit të zonës.



21% e të rinjve nga zonat urbane dhe 16% e të rinjve nga zonat rurale janë shprehur se kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga Bashkia (Ndonjëherë ose shpesh). Ndërsa 20% e të rinjve në zonat rurale dhe 7% e të rinjve në zonat urbane shprehen se marrin pjesë gjithmonë në takimet e Bashkisë.


Nga të rinjtë që janë informuar mbi programet e Bashkisë, rezulton se mjeti më i përdorur për marrjen e informacionit nga Bashkia janë:

a. Faqja zyrtare e Bashkisë (20%) – për të rinjtë në zonat rurale

b. Portalet online (29%) – për të rinjtë në zonat urbane


Broshurat dhe njoftimet publike mbeten gjithashtu mjete informuese të përdorura gjerësisht nga të rinjtë.

Ndërkohë Buletini informativ është një instrument aspak i përdorur nga të rinjtë e anketuar të zonave urbane dhe rurale për marrjen e informacioneve mbi programet dhe shërbimet që ofron Bashkia.



Aktivitetet argëtuese dhe kulturore dhe **takimet e vazhdueshme informuese** janë programet më të preferuara që të rinjtë do të donin të përfitonin nga Bashkia e Fierit. Gjithashtu të rinjtë kanë identifikuar si shërbime të preferuara edhe ofrimin e mundësive të punësimit, bursave, funksionimin e forumeve rinore dhe organizatave të shoqërisë civile.


Përqindja e të rinjve që do të donin që Bashkia të ofronte shërbimet e mëposhtme për të rinjtë



17 % e të rinjve vlerësojnë shumë mirë ofrimin e shërbimeve administrative të Bashkisë në përputhje me nevojat e të rinjve, ndërsa 20% e të rinjve vlerësojnë maksimalisht ngritjen dhe funksionimin e zyrave me një ndalesë në Bashki.

Përqindja e të rinjve të cilët vlerësojnë me pikët më poshtë shërbimet që janë ofruar nga Bashkia për të rinjtë

(1- vlera më e vogël, 5- vlera më e madhe)



TË RINJTË BASHKIA E FIERIT



Leave
No One
Behind

